

iSIGURIMET

Nr. #045-046 • Korrik - Gusht 2023 • www.bks-ks.com

**35,6 milionë euro
dëme u paguan
vetëm për 6 muaj**

03




**MAZREKU: URGJENTISHT
TË OBLIGOHEM SIGURIMI I
PUNËTORËVE
NË NDËRTIMTARI**

02

STIKERAT DHANË REZULTATIN

04



MAZREKU: URGJENTISHT TË OBLIGOHEM SIGURIMI I PUNËTORËVE NË NDËRTIMTARI

Mazreku bëri me dije se është i gatshëm të diskutojë me akterët institucionale që të gjejnë zgjidhje për punëtorët në sektorin e ndërtimitarisë që ata të jenë të siguruar.

Viteve të fundit disa punëtorë në Kosovë kanë humbur jetën në vendet e tyre të punës. Një punëtor ka humbur jetën ditën e hënë në Prishtinë, punëtori ka rënë nga një lartësi, derisa ishte duke punuar. Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, tha se mungesa e sigurimeve të detyrueshme në vendet e punës në Kosovë është një problem që mund të zgjidhet shumë lehtë, por duhet vendosmëri nga ana e institucioneve të Kosovës. Mazreku tha se sigurimi i punëtorëve duhet të obligohet me

ligj dhe akte tjera. Ai në një intervistë të dhënë në RTK, bëri me dije se më parë ka dorëzuar letra te kryetarët e komunave të Kosovës, që në kuadër të lejes ndërtimore që e lëshojnë për kompanitë e ndërtimit, ato të obligohen edhe të blejnë një policë të sigurimit për punëtorë, që do të ishte një garancion për sigurinë e punëtorëve. Drejtori Mazreku bëri me dije se është i gatshëm të diskutojë me akterët institucionale që të gjejnë zgjidhje për punëtorët në sektorin e ndërtimitarisë që ata të jenë të siguruar.

Sektori sigurimeve nga minus 24,7 milionë euro humbje, në 9.9 milionë euro fitim.

Të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) pasqyrojnë shumë saktë rezultatet e një angazhimi të madh për rregullimin dhe reformimin e sektorit të sigurimeve në vend.

Gjatë tetë viteve, pra 2016-2023, janë bërë punë dhe ndryshime të mëdha, e që falë tyre sektori i sigurimeve sot është krejtësisht tjetër, i barabartë me ato të shteteve të zhvilluara Evropiane.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë ndryshimi i Ligjit të Korporatave e që në masë të madhe ky ligj kishte dëmtuar sektorin e sigurimeve në vend, pasi që deri në ndryshimet ligjore kompanitë kanë paguar tatime shtesë prej 5 % të qarkullimit bruto.

Gjithashtu, me vendim të Gjykatës Kushtetuese gjatë kësaj periudhe kohore të cilës i referohemi është ndryshuar edhe Ligji për Kryqin e Kuq, ku deri në shfuqizimin e këtij ligji kompanitë është dashur të paguajnë për këtë Institucion 1 % të qarkullimit të përgjithshëm.

Gjatë kësaj periudhe kohore me vendim të Bankës Qendrore të Kosovës nga tregu i sigurimeve janë hequr edhe dy kompani të sigurimeve të cilët nuk kishin rënë nën kushtet ligjore të para para me ligjet në fuqi.

Zvogëlimi i automjeteve të paregjistruara në vend gjithashtu ka ndikuar dukshëm në rregullimin e tregut. Në këtë drejtim është duke u punuar në vazhdimësi, projekti për vendosjen e stikerave ka dhënë rezultate konkrete. Gjatë vitit që vjen rezultatet në këtë drejtim do të jenë edhe më të dukshme.

Për ndryshimet pozitive gjatë kësaj periudhe kohore sektori i sigurimeve është përmendur edhe në konotacion pozitiv edhe në raportin e progresit për

Kosovën.

Pra, duke iu referuar të dhënave zyrtare më 2016, sektori i sigurimeve ka mbyllur vitin me 24,7 milionë euro humbje, derisa në fund të muajit korrik të këtij viti, pra për shtatë muaj, sektori ka gjeneruar një profit neto prej 9,9 milionë euro.

Falë ndryshimeve që janë bërë në aspektin teknik Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret për tu bërë pjesë e Byrosë së Kartonit të Gjellbër.



BKS

Byroja Kosovare e Sigurimit
Kosovski Ured Osiguranja
Kosovo Insurance Bureau

35,6 MILIONË EURO DËME U PAGUAN VETËM PËR 6 MUAJ

Gjatë periudhës janar-qershor 2023 kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit, në emër të shpagimit për palët e dëmtuara, kanë paguar hiç më pak se 35,6 milionë euro, nga 27,8 sa ishte gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Krahasuar me përqindje, pagesa e dëmeve gjatë periudhës janar-qershor 2023 me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rrit për më shumë se 28 %.

iSIGURIME

Pagesë rekorde e dëmeve për palë të dëmtuara ka ndodh gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti nga kompanitë e sigurimeve, por edhe nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS). Viteve të fundit si trajtimi i dëmeve, ashtu edhe kompensimi i tyre, është duke u bërë në një afate rekorde. Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se vetëm gjatë kësaj periudhe janë paguar hiç më pak se 35,6 milionë euro, nga 27,8 milionë euro sa ishte gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Krahasuar me përqindje, pagesa e dëmeve gjatë periudhës janar-qershor 2023 me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rritur për më shumë se 28 %. Valon Berisha, drejtor Financiar në Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS), tregon për iSIGURIME se pagesa e dëmeve është duke u bërë në afat të shpejtë kohor. Më tutje drejtori Berisha ka treguar se asnjëherë më parë, si trajtimi i dëmeve, ashtu edhe kompensimi po behen shumë shpejt. “Siç e kam thënë edhe më herët, me ardhjen e menaxhmentit të

ri trajtimi i dëmeve dhe kompensimit në BKS bëhet në afate kohore rekorde. Një gjë e tillë po ndodh edhe nëpër kompani të sigurimit, ku trajtimi dhe kompensimi po behen shumë shpejt. Çdo ditë numri i lendeve që shkojnë në gjykatë nga palët e pakënaqura është duke rënë në masë të madhe” ka thënë më tutje drejtori Berisha.

PAGESA NË KATËR VITET E FUNDIT

Gjithnjë duke u bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, shihet se deri në muajin qershor të këtij viti kompanitë e sigurimeve dhe BKS-ja, në emër të pagesës së dëmeve për palët e dëmtuara kanë paguara hiç më pak se 35.6 milionë euro, nga 27,8 sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, sipas të dhënave zyrtare shihet se gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2021 në emër të dëmeve janë paguar 21,6 milionë euro, derisa në periudhën janar-qershor 2020 në emër të pagesës së dëmeve për palët e dëmtuara janë paguar 21 milionë euro.

MILIONË	2023	2022	2021	2020
Qershor	35.6	27.8	26.1	21.0
Maj	30.5	22.7	21.6	17.2
Prill	25.2	17.1	17.8	14.4
Mars	20.1	13.3	13.7	12.7
Shkurt	13.2	8.2	7.8	9.6
Janar	8.2	4.4	3.9	4.9

MAZREKU: STIKERAT

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku në një intervistë për “iSIGURIME” tregon për ndikimin që ka pasur vendosja e stikerave në xhama të automjeteve. Ai gjithashtu tregon se automjetet e pasiguruara në vend kanë qenë dëmtuesit më të mëdhenj të sektorit të sigurimeve, ku vetëm për 10 vjet janë paguar më shumë se 40 milionë euro për të kompensuar palët e dëmtuara. Sipas tij, edhe sivjet pagesa e dëmeve për palët e dëmtuara është duke u kryer shpejt. Drejtori Mazreku thotë se falë punës dhe angazhimit të madh që janë duke bërë institucionet shumë shpejtë në rrugët e Kosovës nuk do të ketë më vetura të paregjistruara.

Aksionet e policisë për identifikimin e automjeteve të pa regjistruara duhet të vazhdojnë çdo ditë pasi automjetet e tilla përpos që në masë të madhe rrezikojnë pjesëmarrësit në komunikacion, ato njëkohësisht e dëmtojnë buxhetin e shtetit dhe kompanitë e sigurimeve, kur dihet se vlera e taksave që paguhen për shtet në momentin e regjistrimit janë të barabarta me çmimin e një policë të sigurimit. Kështu ka thënë drejtori BKS-së Sami Mazreku në një intervistë për iSIGURIME.

iSIGURIME: z.Mazreku, policia e Kosovës ka nisur një aksion për konfiskimin e tabelave për automjetet e pasiguruara, si e vlerëson këtë?

Mazreku: Si në të kaluarën, ashtu edhe tash ne vlerësojmë lart veprimet e Policisë së Kosovës të cilat kanë për qëllim zbatimin e ligjeve të aplikueshme në vendin tonë. Dalja me automjet pa policë siguri në komunikacion, që në Kosovë është shndërruar në një praktikë të keqe, bie ndesh me ligjet në fuqi e që deri më tash thuajse të gjitha pasojat që kanë shkaktuar ata i ka bartur Byroja Kosovare e Sigurimit. Nëpër vite kemi paguar dhjetëra milionë euro për automjetet e pasiguruara të cilat kanë shkaktuar dëme në komunikacion dhe këto dëme deri para dy vitesh thuajse nuk janë inkasuar për shkak të procedurave të gjata nëpër Gjykata. Vetëm në dy vitet e fundit, pas ndryshimit të menaxhmentit në BKS-së, është punuar seriozisht në këtë drejtim, ku dhe janë inkasuar me shumë se 1 milionë euro në emër regreseve, pra dëme që ka paguar BKS-ja për palë të dëmtuara, por më vonë përmes procedurave Gjyqësore këto mjete BKS-ja i ka marrë nga shkak-tari i aksidentit. Aksionet e policisë për identifikimin e automjeteve të tilla duhet të vazhdojnë çdo ditë pasi që automjetet e tilla përpos që në masë të madhe rrezikojnë pjesëmarrësit në komunikacion, ato njëkohësisht dëmtojnë buxhetin e shtetit dhe kompanitë e sigurimeve, kur dihet se



Nëpër vite kemi paguar dhjetëra milionë euro për automjetet e pasiguruara të cilat kanë shkaktuar dëme në komunikacion dhe këto dëme deri para dy vitesh thuajse nuk janë inkasuar për shkak të procedurave të gjata nëpër Gjykata.


SAMI MAZREKU

vlera e taksave që paguhen për shtet në momentin e regjistrimit janë të barabarta me çmimin e një policë të sigurimit. Ne si BKS shpresojmë se veprimet të policisë të ndodhin çdo ditë.

iSIGURIME: Sa e kanë dëmtuar ndër vite industrinë e sigurimeve automjetet e pasiguruara në vend?

Mazreku: Ashtu siç e kam potencuar edhe më parë dëmet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në Kosovë janë tepër barrë e madhe për Industrinë e sigurimeve. Sipas statistikave që ne kemi vetëm në 11 vitet e fundit vlera e dëmeve të paguara është gati 50 milionë euro. Në vitin 2012 shuma e dëmeve të paguara për demet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara ka qenë hiç më pak se 3,500,528 euro, derisa në vitin 2013 shuma e dëmeve të paguara për këtë qëllim ka qenë 3,756,892 euro. Po ashtu, në vitin 2014 shuma e mjeteve të paguara për aksidentet e shkaktuara nga automjetet pasiguruara ka qenë 2,793,902 euro, derisa në vitin 2015 shuma e paguar ka qenë 3,229,362 euro. Në vitin 2016 shuma e dëmeve të paguara për aksidentet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara ka qenë 3,336,121 euro, Derisa në vitin 2017 shuma e dëmeve të paguara për këtë qëllim ka qenë 3,328,898. Edhe në vitin 2018 për këtë qëllim janë paguar 3,402,319 euro, e në vitin 2019 janë paguar 4,436,611 euro. Në vitin 2020 për demet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara shuma ka qenë 3,480,871, në vitin 2021 shuma e dëmeve të paguara ka qenë 5,649,422, derisa në vitin 2022 shuma e mjeteve të paguara për aksidentet e shkaktuara nga automjetet e pasiguar ka qenë 4,551,408. Nëse i referohemi me numra atëherë gjatë vitit 2012 Byroja Kosovare e Sigurimit i ka paguar 2139 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, gjatë vitit 2013 janë paguar 2,345 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, në vitin 2014 janë paguar 1891 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara. Gjithashtu në vitin 2015 janë paguar 1447 dëme, Derisa në vitin 2016 janë paguar

DHANË REZULTATIN



1,547 dëme. Edhe në vitin 2017 nga Byroja Kosovare e Sigurimit janë paguar 1993 dëme, Në vitin 2018 janë paguar 1,766 dëme të shkaktuara nga automjetet e pa siguruar në vend, në vitin 2019 nga Byroja janë paguar 1796 dëme, e në vitin 2020 janë paguar 1,600 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në vend. Po ashtu edhe në vitin 2021 janë paguar 2740 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, derisa në vitin 2022 janë paguar 2,198 dëme të shkaktuara nga automjetet e pasiguruara në vend. Pra, siç edhe po shihet si në vlerë monetare ashtu edhe në numër kostoja është shumë e madhe. Ne shpresojmë dhe besojmë se pas angazhimit të policisë dhe fushatave të shumta vetedijesuese që ne kemi realizuar rreth pasojave që krijoj djallja me automjet

të peregjistruar në rrugë do të bije edhe numri i aksidenteve.

iSIGURIME: Në raport me vitet paraprake, dukshëm ka rënë edhe numri i automjeteve të peregjistruara, a kanë ndikuar në këtë drejtim edhe vendosja e stikerave ?

Mazreku: Vendoja e stikerave në xhama të automjeteve është njeri prej projekteve më të rëndësishme të BKS-së e cila është mbështetur financiarisht 100 % nga kompanitë e sigurimit në vendin tonë. Padyshim se vendosja e stikerave ka dhënë rezultate të dukshme, pasi që në bazë të ngjyrës së stikersit policia pa ndalur fare e identifikon nëse automjeti ka apo nuk ka regjistrim. Në bazë të dhënave zyrtare numri i automjeteve të peregjistruara ka rënë në 5 % nga

më shumë se 20 sa ishte me pare. Ne jemi duke punuar shumë që këtë numër ta ulim edhe më poshtë, apo më mirë të themi në pikën zero. Siç e kam potencuar shumë herë më parë, numri i madh i automjeteve të peregjistruara rrezikon pjesëmarrësit në komunikacion, pasi ato automjete janë të pakontrolluara teknikisht, dëmton rëndë buxhetin e Kosovës, pasi që ato automjete nuk paguajnë fare taksa, dëmtojnë kompanitë e sigurimeve, pasi që sipas ligjeve në fuqi dëmet e shkaktuara nga automjetet e peregjistruara mbulohen nga BKS-ja, por më pas kjo e fundit e gëzon të drejton ligjore për rimbursim të mjeteve nga shaktari i aksidentit. Dhe jo e fundit për nga rëndësia, numri i madh i automjeteve të peregjistruara bllokton çdo iniciativë dirtekte apo indi-

rekte për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.

iSIGURIME: Gjatë kësaj kohe ju keni realizuar edhe shumë fushata sensibilizuese. A janë duke dhënë efektet në praktikë ?

Mazreku: Nga dita e parë e vitit e deri në përfundim Byroja Kosovare e Sigurimit në vazhdimësi ka aktivitete që kanë për qëllim sensibilizimin e opinionit. Për këtë qëllim tash e një vit ne promovojmë fushatën tonë me moton “ Mos dil pa policë sigurimi”, ku baneri është i pranishëm në shumë media online, por edhe në monitorin e madh në hyrje të Prishtinës. Po ashtu, në sivej kemi organizuar disa tryeza me gazetarë që përcjellin sektorin e sigurimeve, por kemi mbajtur edhe shumë aktivitete në shkolla fillore, mesme, por edhe në Universitete Publike e kolegje private. Pra, i gjithë ky angazhim i jonë së bashku me projektin për vendosjen e stikerave ka dhënë rezultate konkrete në uljen e numrit të automjeteve të peregjistruara në vend, pra ky ka qenë qëllimi jonë i vetëm. Si pasojë e vetëdijesimit të qytetarëve sivej kemi edhe numër më të vogël të aksidentëve më pasojë fatale, por edhe numër më të vogël të qytetarëve që kanë humbur jetën në aksidente komunikacioni.

iSIGURIME: A mund të ulet në zero numri i automjeteve të pasiguruara në vend ?

Mazreku: Kur kemi nisur angazhimet tona në kohën kur numri në automjeteve të peregjistruara në regjistrat e Agjencisë së Regjistrimit të Automjeteve ishte mbi 20 %, askush nuk besonte se s’do të kishte sukses në këtë drejtim, por kur tash numri është rreth 5 % ne besojmë dhe shpresojmë se nuk është e largët dita kur numri i automjeteve të peregjistruara në Kosovës do të jetë zero.

iSIGURIME: A është duke vazhduar me trend të njëjtë pagesa e dëmeve edhe gjatë këtij viti, sikurse viteve tjera si në BKS, ashtu edhe në nëpër kompani të sigurimeve ?

Mazreku: Pagesa e dëmeve ashtu sikurse gjatë vitit të kaluar është duke u kryer korrekt dhe shpejt. Sipas të dhënave që në disponojmë shihet se vetëm gjatë pesë muajve të parë të këtij viti shuma e premive të pranuar nga kompanitë e sigurimeve ka qenë 53 milionë euro, derisa shuma e dëmeve të paguara është 30,5 milionë euro. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gati gjysma e të hyrave totale të kompanive të sigurimeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve gjatë 5 viteve të fundit është shpenzuar për kompensim të dëmeve. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë kësaj periudhe kohore vlera e primeve të shkuara ka qenë 539 milionë euro, derisa vlera e dëmeve të paguara 260 milionë euro. Në vitin 2018 sipas të dhënave të BQK-së shihet se vlera e Primeve të shkuara bruto ka qenë 92.1 milionë euro, derisa vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe BKS-ja ka qenë 42,9 milionë euro. Bazuar në këto të dhëna del se 46 % e të hyrave totale gjatë vitit 2018 janë shpenzuar vetëm për kompensim të dëmeve. Po ashtu, edhe gjatë vitit 2019 të hyrat totale të kompanive të sigurimeve nga Primet e shkuara Bruto kanë arritur në



“Pagesa e dëmeve ashtu sikurse gjatë vitit të kaluar është duke u kryer korrekt dhe shpejt. Sipas të dhënave që në disponojmë shihet se vetëm gjatë pesë muajve të parë të këtij viti shuma e premive të pranuar nga kompanitë e sigurimeve ka qenë 53 milionë euro, derisa shuma e dëmeve të paguara është 30,5 milionë euro”, ka thënë Sami Mazreku.

99,2 milionë euro, derisa gjatë këtij viti në emër të dëmeve kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimeve kanë paguar hiç më pak se 47,9 milionë euro. Gjatë këtij viti shihet se mbi 48 % e të hyrave totale të kompanive janë shpenzuar për kompensim të dëmeve për palë të dëmtuara. Në vitin 2020 shuma e premive

të pranuar ka qenë rreth 98 milionë euro, derisa shuma e dëmeve të paguara ka qenë 47 milionë euro. Në vitin 2021 shuma e premive të pranuar ka qenë 114 milionë euro, derisa shuma e dëmeve të paguara ka qenë 54 milionë euro. Në vitin 2022 sipas të dhënave të BQK-së shihet se shuma e premive të pranuar nga kompanitë ka qenë



“Po ashtu, sipas këtij udhëzimi organizatori i paketës duhet që përmes polisës së sigurimit të mbulojë kompensimin e udhëtarit për shpenzimet e strehimit të nevojshëm, ushqimin dhe kthimin në vendin e nisjes në Kosovë apo jashtë vendit, si dhe të gjitha pretendimet e tjera në këtë drejtim, në rast të falimentimit të organizatorit, nëse transporti ishte përfshirë në kontratën e paketës së udhëtimit”, ka thënë Sami Mazreku.

të dhënave të automjeteve të pajisura dhe përfundimisht nuk lejon që të rritet rreziku nga veturat e pajisura. Nuk ka logjikë që dikush ta shesë një veturë dhe ta lërë me vite të tëra të lëvizë lirshëm diku tjetër pa e ditur se për çfarë qëllimi përdoret ajo veturë. Edhe sot me kontratë noteriale është e cekur që një person është i obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës noteriale brenda 10 ditësh ta ndërrojë sigurimin sepse nëse ajo veturë është në emër të dikujt dhe nëse ai bën tri aksidente, atëherë atij tri herë i rritet siguri dhe kjo krijon pasoja tjera pa qenë në dijeni fare personi.

iSIGURIME: Po ashtu me udhëzimin e ri administrativ 05/2003, i cili është mbështetur në Ligjin e Truizmit agjencitë turistike duhet t'i sigurojnë udhëtarët. Si e vlerësoni këtë ?

Mazreku: Po me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ 05/2003, i cili është mbështetur në Ligjin e Truizmit, Agjencitë Turistike duhet t'i sigurojnë klientët e tyre. Tash e tutje klientët do të jetë të siguar në realizimin e së drejtës së tyre përmes policës së sigurimit. Pra, nëse kompania nuk përmbush marrëveshjen që ka me klientin, atëherë Institucionet përgjegjëse mund të ekzekutojnë sigurimin dhe të kompensojnë palën e dëmtuar. Më saktësisht në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ thuhet se Agjencia e Udhëtimit duhet të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të saja kontraktuale ndaj palëve të treta përmes një polise të vlefshme sigurimi. Polisa e sigurimit duhet të mbulojë kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj udhëtarit nga mos përmbushja, plotësimi i pjesshëm ose përmbushja e parregullt e detyrimeve sipas marrëveshjes së udhëtimit, itinerarit të udhëtimit ose itinerarit të ekskursionit si dhe kompensimi i dëmeve të shkaktuara për shkak të pamundësisë së agjencisë së udhëtimit për të shlyer kostot e nevojshme të strehimit/akomodimit, ushqimit dhe kthimit të udhëtarëve nga një udhëtim në vendin e nisjes, brenda dhe jashtë vendit. Polisa e sigurimit duhet të mbulojë edhe rastet e pamundësisë së përmendura më sipër të shkaktuara nga falimentimi i agjencisë së udhëtimit, thuhet më tutje në pikën 1 të nenit 5 të këtij udhëzimi administrativ. Më tutje në pikën 2 po të këtij neni thuhet se organizatori i paketës duhet që përmes polisës së sigurimit të mbulojë rimbursimin e të gjitha pagesave të bëra nga ose në emër të udhëtarit në lidhje me kontratën e udhëtimit për pakot dhe shërbimet që nuk kanë ose nuk do të kryhen ose do të kryhen vetëm pjesërisht si pasojë e falimentimit apo falimentimit të organizatorit. Po ashtu, sipas këtij udhëzimi organizatori i paketës duhet që përmes polisës së sigurimit të mbulojë kompensimin e udhëtarit për shpenzimet e strehimit të nevojshëm, ushqimin dhe kthimin në vendin e nisjes në Kosovë apo jashtë vendit, si dhe të gjitha pretendimet e tjera në këtë drejtim, në rast të falimentimit të organizatorit, nëse transporti ishte përfshirë në kontratën e paketës së udhëtimit. Byroja Kosovare e Sigurimit falënderon Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për ketë ndryshim ligjor i cili në masë të madhe do të mbroj qytetaret e Kosovës.

127,7, derisa vlera e dëmeve të paguara ka qenë 57,7 milionë euro

iSIGURIME Si është duke performuar sivjet sektori i sigurimeve në vend ?

Mazreku: Duke iu referuar të dhënave zyrtare të BQK-së shihet se sektori i sigurimeve për të katërtin vit me radhë shënoi rritje dyshifrore në asete, kryesisht i ndikuar prej burimit kryesor financues – primeve të shkruara nga policat e shitura. Po ashtu, sektori për të tretin vit me radhë operoi me rezultate pozitive financiare. Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2022 shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore kundrejt vitit të kaluar, si rrjedhojë e bazës së ulët të primeve të shkruara në vitin 2020 (si rezultat i shpërthimit të pandemisë Covid-19). Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2022 arriti në 134.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.1 përqind. Pra, çdo ditë e me shumë sektori i sigurimeve në Kosovës është duke u konsoliduar edhe më shumë, duke ofruar shërbime sikurse në shtete të

zhvilluara Evropiane.

iSIGURIME: Vendimi i ri i ARC-së i obligon qytetarët t'i çregjistrojnë veturat e vjetra, si e vlerësoni këtë ?

Mazreku: Është thënë në rregullore që një qytetar kur shkon ta regjistrojë një veturë, e ka obligative të tregojë se ku i ka veturat tjera që janë të pajisura. Nëse ti i ke pesë vetura të regjistruara, askush nuk merret me ty, mirëpo nëse shkon ta regjistrosësh një veturë dhe në sistem figuron se në emrin tuaj ekzistojnë edhe dy ose tri vetura të pajisura, automatikisht duhet të merrni veprime që ato vetura t'i regjistrojë ose me t'i ç'lajmëroni që të mund ta vazhdoni këtë proces. Këtë iniciativë e mirëpresim dhe e falënderojmë ARC-në, sepse pavarësisht se dikujt mund të mos i pëlqejë, ky është veprim ligjor dhe e pastron bazën e

ZHVILLIMI TREGUT KATËR VITET E FUNDIT

Gjatë periudhës janar-qershor 2023 shitja e policave të sigurimit përfshirë ato obligative, vullnetare e kufitare është rritur për 22 përqind në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Nëse e bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 atëherë shihet se shitja e policave është rritur për 41.45 %, derisa në raport me periudhën janar-qershor 2022 atëherë shihet se shitja e policave është rritur rreth 81 %. Bazuar në statistika zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se tregu i sigurimeve gjatë katër viteve të fundit është zhvilluar dukshëm në raport me vitet paraprake.

NDARJA E TREGUT, JANAR-QERSHOR 2023

Total	TPL	Kufitare	Vullnetare
94.037	40.125	16.751	37.160
177.359	77.676	14.524	85.159
287.775	122.471	52.953	123.199
407.013	157.927	89.802	159.284
514.259	203.618	115.043	195.598
628.336	257.662	142.125	228.549

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se deri në fund të muajit qershor të këtij viti, pra 2023, kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë shitur 628.336 polica të sigurimit. Nga kjo shifër 257.662 janë polica TPL, 142.125 janë polica kufitare si dhe 228.549 janë polica vullnetare.

NDARJA E TREGUT, JANAR-QERSHOR 2022

Total	TPL	Kufitare	Vullnetare
78.152	36.848	13.208	28.096
149.785	72.351	27.999	50.435
227.069	110.894	42.085	74.090
315.286	141.766	74.165	99.355
404.928	183.946	96.750	124.232
515.328	237.921	124.116	153.291

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se deri në fund të muajit qershor të këtij viti, pra 2022 kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë shitur 515.328 polica të sigurimit. Nga kjo shifër 237.921 janë polica TPL, 124.116 janë polica kufitare si dhe 153.291 janë polica vullnetare.

80,87%

është rritur shitja e policave gjatë periudhës janar-qershor 2023, në raport me periudhën e njëjtë janar-qershor 2020.

41,46%

është rritur shitja e policave gjatë periudhës janar-qershor 2023, në raport me periudhën e njëjtë janar-qershor 2021.

22,00%

është rritur shitja e policave gjatë periudhës janar-qershor 2023, në raport me periudhën e njëjtë janar-qershor 2022.

NDARJA E TREGUT, JANAR-QERSHOR 2021

Total	TPL	Kufitare	Vullnetare
71.498	34.416	17.576	19.506
135.663	66.685	36.151	32.827
206.008	100.679	57.969	47.360
263.232	124.809	77.968	60.455
347.712	162.683	111.210	73.819
444.186	214.177	137.557	92.451

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se deri në fund të muajit qershor të këtij viti, pra 2021 kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë shitur 444.186 polica të sigurimit. Nga kjo shifër 214.177 janë polica TPL, 137.557 janë polica kufitare si dhe 92.451 janë polica vullnetare.

NDARJA E TREGUT, JANAR-QERSHOR 2020

Total	TPL	Kufitare	Vullnetare
77.010	31.537	15.458	30.015
152.554	61.539	30.650	60.365
197.157	82.182	38.253	76.722
223.051	96.126	40.272	86.653
267.256	127.569	44.195	95.492
347.403	172.486	65.567	109.350

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se deri në fund të muajit qershor të këtij viti, pra 2020 kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë shitur 347.403 polica të sigurimit. Nga kjo shifër 172.486 janë polica TPL, 65.567 janë polica kufitare si dhe 109.350 janë polica vullnetare.



628.336 POLICA TË SHITURA PËR 6 MUAJ

Gjatë periudhës janar-qershor 2023, kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë shitur 628.336 polica nga 515.328 sa ishin shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Numri i policave të shitura sivjet është 22 % më i lartë se sa gjatë periudhës janar-qershor 2022.

ISIGURIME

Rritja e vazhdueshme e tregut të sigurimeve në vend ka rritur edhe numrin e policave të shitura. Bazuar të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë periudhës janar-qershor 2023 kompanitë e sig-

urimeve, si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë shitur 628.336 polica nga 515.328 sa ishin shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Numri i policave të shitura sivjet është 22% më i lartë se sa gjatë periudhës janar-qershor 2022. Sipas përfaqësuesve të

industrisë së sigurimeve në vend thuhet se tregu i sigurimeve është duke u zhvilluar me hapa të shpejt, sidomos gjatë viteve të fundit. Sipas tyre bazuar në statistika zyrtare shihet se tregu i sigurimeve obligative me ato vullnetare gati është barazuar.

628.336 polica kanë shitur kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit gjatë periudhës janar-qershor 2023.

515.328 polica kanë shitur kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit gjatë periudhës janar-qershor 2022.

MUAJI	2023	2022	2021	2020
Qershor	628.336	515.328	444.186	347.403
Maj	514.259	404.928	347.712	267.256
Prill	407.013	315.826	263.232	223.051
Mars	287.755	227.069	206.008	197.157
Shkurt	174.359	149.785	135.663	152.554
Janar	94.037	78.152	71.498	77.001

AVOKATI POPULLIT APROVON ANKESËN E SAMI MAZREKUT, LIGJI PËR TATIMIN NË PRONË DUHET TË NDRYSHOHET

Avokati i Popullit ka aprovuar kërkesën e drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) z. Sami Mazreku, kundër Kuvendit të Kosovës, për ndryshimin e Ligjit për Tatimin në Pronë e Paluajtshme.

Deri para kohës kur Mazreku ka bërë ankesën në zyrën e Avokatit të Popullit për të regjistruar veturat e tyre, qytetarët është dashur të paguajnë tatimin në pronë.

Derisa pas ankesës së drejtorit Mazreku kjo praktikë diskriminuese e komunave të Kosovës më nuk aplikohet fare.

“Avokati i Popullit në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit numër 05/L-019 për Avokatin e Popullit ka pranuar ankesë nga z. Sami Mazreku, parashtruar kundër Kuvendit të Kosovës lidhur me miratimin e Ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme” thuhet më tutje në vendimin.

Më tutje se Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Financave të ndërmarrë nismën legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, në mënyrë që neni numër 29 të hiqet në tersi. Përndryshe, drejtori i BKS-së z. Sami Mazreku që nga fillimi ka deklaruar se kushtë-



zimi i qytetarëve në pagesën e tatimit në pronë si kusht për të regjistruar automjetin është antikushtetues.

zimi i qytetarëve në pagesën e tatimit në pronë si kusht për të regjistruar automjetin është antikushtetues.

BKS MIRËPRET VENDIMIN QË I OBLIGON QYTETARËT T'I ÇREGJISTROJNË VETURAT E VJETRA

Vendimi i Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) që i obligon qytetarët që të tregojnë se ku i kanë veturat e peregjistruara, është mirëpritur nga Byroja Kosovare e Regjistrimit (BKS). Ndërkohë për këtë vendim, Ekonomia Online nuk ka marrë përgjigje nga drejtori i Agjencisë për Regjistrim Civil, Blerim Camaj. Ky i fundit, nuk iu është përgjigjur thirrjeve të redaksisë. Sipas drejtorit të BKS-së, Sami Mazreku, ky vendim mund të mos u pëlqejë qytetarëve por që e pastron bazën e të dhënave të automjeteve të peregjistruara.

“Është thënë në rregullore që një qytetar kur shkon për ta regjistruar një veturë, e ka të obligueshme të tregojë se ku i ka veturat tjera që janë të peregjistruara. Nëse ti i ke pesë vetura të regjistruara, askush nuk merret me ty, mirëpo nëse shkon ta regjistrosësh një veturë dhe në sistem figuron se në emrin tuaj ekzistojnë edhe dy ose tri vetura të peregjistruara, automatikisht duhet të merrni veprime që ato vetura t'i regjistroni ose me t'i ç'lajmëroni që të mund ta vazhdoni këtë proces”. “Edhe këtë iniciative e mirëpresim dhe e falënderojmë ARC-në, sepse pavarësisht dikujt mund të mos i pëlqejë, ky është veprim ligjor dhe e pastron bazën e të dhënave të automjeteve të peregjistruara dhe përfundimisht nuk lejon që rreziku i veturave të peregjistruara të rritet”, thotë ai. Teksa ka folur për këtë dukuri, Mazreku ka



marrë si shembull aksidentet e shkaktuara nga vetura e shitura. Thotë se ende mund të figurojnë në emër të shitësit. “Nuk ka logjikë që dikush ta shesë një veturë dhe me vite të tëra ta lërë të lëvizë lirshëm diku tjetër pa e ditur se për çfarë qëllimi përdoret ajo veturë”. “Edhe sot me kontratë noteriale është e cekur që një person është i obliguar që

në momentin e nënshkrimit të kontratës noteriale brenda 10 ditësh ta ndërrojë sigurimin sepse nëse ajo veturë është në emër të dikujt dhe nëse ai bën tri aksidente, atëherë atij tri herë i rritet sigurimi dhe kjo krijon pasoja tjera pa qenë në dijeni fare personi”, u shpreh ai, teksa apeloj te qytetarët që të mos i lënë veturat në emër të huaj.



ÇKA ËSHTË SIGURIMI

Marrja sigurimit është një proces me të cilin një person, i quajtur mbajtës i policës, në këmbim të një pagese i kalon një kompanie të sigurimit rrezikun e humbjes që do donte ta shmangte, e cila quhet Primi Sigurimit. Njerëzit përdorin sigurimin për tu mbrojtur nga rreziku i humbjes së mundshme, por të pasigurt. Mbajtësi i policës zotohet për një kosto të ditur (primi) në këmbim që kompania e kontraktuar e sigurimeve të mbulojë shpenzimet më të mëdha, në rast të një ngjarje të padëshirueshme.

Llojet e Sigurimit: ka shumë lloje të ndryshme të sigurimit. Njerëzit mund të sigurohen kundër pothuajse çdo rreziku të mundshëm - me një çmim. Më poshtë janë katër llojet kryesore të sigurimit që shumica e njerëzve i konsiderojnë dhe rreziqet kryesor që janë duke u siguruar ndaj secilës prej tyre.

Polica Sigurimit: Mbajtësi i policës do të marrë një kontratë, zakonisht të quajtur si polica e sigurimit, që do të përcaktoj kushtet e policës dhe rrethanat në të cilat i/e siguruari/a do të kompensohet. Polica gjithashtu mund t'i listojë lirimet apo përjashtimet të cilat nuk do të kompensohen.

Për shembull, polica sigurimit shëndetësor shpesh liston si përjashtim kompensimin në rast të sëmundjes apo dëmtime të vetë-shkaktuara ose nga pjesëmarrja në aktivitete të rrezikshme, si lëshimi me parashutë. Personi duhet ta lexojë policën me kujdes para se ta nënshkruaj. Policat e sigurimit mund të jenë komplekse dhe shumë mbajtës të policave mund të mos i kuptojnë të gjitha tarifat, mbulueshmërinë dhe përjashtimet në policës. Duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë përjashtimeve. Aty mund të përfshihen disa nga rreziqet e rëndësishme dhe kompania e sigurimeve nuk do t'i kompensojë mbajtësit e policës edhe në qoftë se ata pësojnë dëme të konsiderueshme.

Natyra e sigurimit: Ngjarjet që kompanitë private të sigurimit zakonisht i sigurojnë, shpesh kanë karakteristikat e mëposhtme:

- Numri i madh: Ka një numër të madh të personave të ekspozuar ndaj të njëjtit rrezik. Kjo ia mundëson kompanisë që të përhap koston e rrezikut mbi një numër të madh të njerëzve;
- Humbja e ditur: madhësia e humbjes, nëse ngjarja e cila ka ndodhur tashmë dihet. Nëse madhësia e humbjes nuk është e ditur me siguri

të arsyeshme, kompania e sigurimit do të ketë vështirësi në vendosjen e një primi të përshtatshëm;

- Ngjarjet e rastësishme: ngjarja, nëse ndodh, është "ngjarje e rastësishme", nëse mbajtësi i policës nuk mund të përcaktojë ose ndikojë në ngjarje. Nëse mbajtësi i policës e shkakton ngjarjen, si për shembull përmes vënies së qëllimshme të zjarrit, zakonisht sigurimi shfuqizohet;
- Mundësia e një humbje të konsiderueshme: Humbja duhet të jetë relativisht e madhe për bartësin e policës. Nëse humbja që vjen nga një ngjarje e padëshirueshme është e ulët, atëherë për personin është më mirë që të "vetë-sigurohet". Në disa fusha, të tilla si sigurimi shëndetësor, shpesh përdoret një përzjerje e të dyjave. Duke u dakorduar me atë që quhet zbritje, personi pajtohet të siguroj veten e tij për ngjarje të vogla mjekësore, të tilla si vizitat e rastit tek mjeku. Sa më e madhe të jetë zbritja, aq më e ulët është primi. Çfarë personi siguron janë shpenzimet e mëdha mjekësore që mund të jenë të vështira për tu financuar;
- Primet e përballueshme: në qoftë se primi është



relativisht i lartë në krahasim me madhësinë e humbjes potenciale me të cilën mbajtësi i policës mendon që mund të përballet, ai mund të vendosë që “vetë-sigurimi” është një alternativë më e mirë për të;

- Rreziku i kufizuar i humbjeve shumë të mëdha: ngjarje të caktuara, të tilla si tërmetet, nëse do të ndodhin, mund të sjellin humbje shumë të mëdha, pasi që do prekin një numër të madh të njerëzve në të njëjtën kohë. Shpeshherë nevojitet një formë e sigurimit nga qeveria në këto lloje të fushave, pasi që rreziku është shumë i koncentruar dhe i paparashikueshme që një kompani private të ofroj siguri kundrejt tij.

Sigurimi përfshin fondet e grumbulluara nga primet e paguara nga shumë mbajtës të policave për të paguar humbjet që një pjesë e vogël e tyre do t'i pësojë. Jo të gjithë mbajtësit e policës do të kenë një aksident apo të sëmurën në të njëjtën kohë. Sa më i madh të jetë numri i personave të siguruar për të njëjtin lloj të rrezikut, aq më shumë ata mund të përfitojnë nga "ligji i numrit të madh", duke shpërndarë rrezikun e tyre dhe duke ulur primet për secilin mbajtës individual të policës. Është e arsyeshme që njerëzit të sigurohen kundër disa prej rreziqeve më të mëdha me të cilat ballafaqohen në jetë, pasi që siguri mund t'i ndihmojë familjet

dhe individët të përgatiten dhe të kompensojnë ndikimin e ngjarjeve të padëshirueshme në pozicionin e tyre financiar. Nëse një person është i pasiguar, ngjarjet e padëshirueshme si sëmundjet, humbja e pasurisë nga zjarri apo një aksident i madh trafiku mund të dëmtojë madje edhe të shkatërrojë situatën financiare të personit apo familjes.

Si vendosin kompanitë e sigurimit mbi primet që do të ngarkojnë? Kompanitë e sigurimit zakonisht përdorin personat e quajtur aktuarët për t'i ndihmuar ata në vendosjen e primeve. Aktuarët përdorin statistika të ngjarjeve të kaluara dhe probabilitetin e ngjarjeve të ardhshme për të vlerësuar shkallën e kërkesave të ardhshme, duke përcaktuar kështu një prim që i lejon kompanisë të përmbush këto kërkesa dhe prapë të ketë fitim. Sa më shumë të ketë mundësi që të ndodh një ngjarje e padëshirueshme ,aq më i lartë do të jetë primi. Një person, për të vendosur se me cilën kompani të sigurimeve të marrë policën e sigurimit, ai duhet të marrë parasysh primet relative që ata do t'i ngarkonin. Por ky nuk është i vetmi element që duhet të marrë parasysh në zgjedhjen e një kompanie sigurimi. Ata duhet të marrin parasysh qëndrueshmërinë financiare të kompanisë (një kompani e dobët mund të mos jetë në gjendje të

paguaj kompensimin, kur mbajtësi i policës ka të drejtë për kompensim) dhe të dhënat e kaluara të kompanisë për pagimin e kërkesave në kohë.

LLOJET E SIGURIMIT

- Sigurimi i jetës
- Sigurimi i automjeteve
- Sigurim i pronës
- Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetësore

LLOJI I RREZIKUT TË MBULUAR

- Vdekje e hershme
- Aksident apo vjedhje
- Zjarr apo dëme tjera të pronës
- Në rast të sëmundjes dhe aksidentit personal



DETYRIM LIGJOR, AGJENCITË TURISTIKE DUHET T'Ë SIGUROJNË UDHËTARËT

ISIGURIME

Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ 05/2003, i cili është mbështetur në Ligjin e Truizmit, Agjencitë Turistike duhet t'ë sigurojnë klientët e tyre. Tash e tutje klientët do të jenë të siguruar në realizimin e të drejtës së tyre përmes policës së sigurimit. Pra, nëse kompania nuk përmbush marrëveshjen që ka me klientin, atëherë Institucionet përgjegjëse mund të ekzekutojnë sigurimin dhe të kompensojnë palën e dëmtuar. Para se të fillojë implementimi i këtij udhëzimi në praktikë është zhvilluar një takim mes përfaqësuesve të Byrosë Kosovare të Sigurimit, respektivisht drejtorit të BKS-së Sami Mazrekut si dhe drejtorit Financiar Valon Berisha, Brahim Isufaj nga BKS-ja, si dhe Lindita Rashica, Merlinda Ramaj, Lumturie Geci, përfaqësuese të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Më saktësisht në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ thuhet se Agjencia e Udhëtimit duhet të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të saja kontraktuale ndaj palëve të treta përmes një polise të vlefshme sigurimi.

“Polisa e sigurimit duhet të mbulojë kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj udhëtarit nga mos përmbushja, plotësimi i pjesëshëm ose përmbushja e parregullt e detyrimeve sipas marrëveshjes së udhëtimit, itinerarit të udhëtimit ose itinerarit të ek-

skursionit si dhe kompensimi i dëmeve të shkaktuara për shkak të pamundësisë së agjencisë së udhëtimit për të shlyer kostot e nevojshme të strehimit/akomodimit, ushqimit dhe kthimit të udhëtarëve nga një udhëtim në vendin e nisjes, brenda dhe jashtë vendit. Polisa e sigurimit duhet të mbulojë edhe rastet e pamundësisë së përmendura më sipër të shkaktuara nga falimentimi i agjencisë së udhëtimit” thuhet më tutje në pikën 1 të nenit 5 të këtij udhëzimi administrativ.

Më tutje në pikën 2 po të këtij neni thuhet se organizatori i paketës duhet që përmes polisës së sigurimit të mbulojë rimbursimin e të gjitha pagesave të bëra nga ose në emër të udhëtarit në lidhje me kontratën e udhëtimit për paketë dhe shërbimet që nuk kanë ose nuk do të kryhen ose do të kryhen vetëm pjesërisht si pasojë e falimentimit apo falimentimit të organizatorit.

Po ashtu, sipas këtij udhëzimi organizatori i paketës duhet që përmes polisës së sigurimit të mbulojë kompensimin e udhëtarit për shpenzimet e strehimit të nevojshëm, ushqimin dhe kthimin në vendin e nisjes në Kosovë apo jashtë vendit, si dhe të gjitha pretendimet e tjera në këtë drejtim, në rast të falimentimit të organizatorit, nëse transporti ishte përfshirë në kontratën e paketës së udhëtimit.

- Për Agjencitë me qarkullim vjetor deri në një qind mijë (100,000) euro, mbulueshmëria e polisës së sigurimit duhet të jetë të paktën tridhjetë mijë (30,000) euro.
- Për agjencitë me qarkullim vjetor nga njëqind mijë (100,000) euro deri në pesëqind mijë (500,000) euro, mbulueshmëria e polisës së sigurimit duhet të jetë të paktën pesëdhjetë mijë (50,000) euro.
- Për Agjencitë me qarkullim vjetor nga pesëqind mijë (500,000) euro deri në një milion euro (1,000,000) euro, mbulueshmëria e polisës së sigurimit duhet të jetë të paktën njëqind mijë (100,000) euro.
- Për Agjencitë me qarkullim vjetor prej një milion euro (1,000,000) deri në dy milion euro (2,000,000) euro, mbulueshmëria e polisës së sigurimit duhet të jetë të paktën dyqind mijë (200,000) euro.

Byroja Kosovare e Sigurimit falënderon Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për këtë ndryshim ligjor i cili në masë të madhe do të mbroj qytetaret e Kosovës.

MAZREKU: RRETH 250 MIJË VETURA ERDHËN NGA DIASPORA, SHUMICA SHMANGËN SERBINË

Situata e sigurisë në veri të Kosovës ka ndikuar që numri i bashkatdhetarëve që vijnë nga pikë kalimi kufitar në Merdare, përkatësisht nëpërmjet territorit të Serbisë, ka shënuar rënie.

Si shkak i kësaj fluksi i mërgimtarëve është rritur në pikë kalimin kufitar në Vermicë, nëpërmjet territorit të Shqipërisë..

Këtë e ka bërë të ditur në një intervistë për Front Online, drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku.

“Nëse Merdarja ka pri gjithmonë si pika më e madhe në Kosovë që aktualisht është edhe më e madhja, sivjet gjatë këtyre dy muajve Vermica ka qenë ajo që e ka marrë primatin ngase qytetarët kanë pasur frikë ndoshta të vijnë nga Serbia dhe kanë ardhur nga rruget e tjera përmes Kroacisë e të tjera. Mirëpo është e vërtetë që në periudhën korrik-gusht, tash deri në fund të gushtit, mund

numri mund t’i kalojë edhe mbi 250 mijë dhe kjo normal që krijon një ngarkesë të madhe në trafik, krijon edhe kolona jo vetëm në Prishtinë por edhe në qytetet tjera dhe është problem për trafikun”, ka thënë ai, për Front Online.

MBI 250 MIJË VETURA ERDHËN NGA DIASPORA NGA QERSHORI DERI NË GUSHT

Sipas tij, ky vit dallon për nga vitet tjera për shkak se mërgimtarët e kanë ndryshuar kohën e ardhjes në Kosovë, derisa ka treguar që për muajt qershor dhe korrik dhe këto ditë të gushtit në Kosovë kanë hyrë mbi 250 mijë vetura.

“Është e vërtetë se kur vjen koha e pushimeve bashkatdhetarët e bëjnë më shumë tollovi në Kosovë, mirëpo sivjet ka ndodhur një ndryshim i vogël për shkak të trazirave që kanë ndodhur kohëve të fundit në pjesën veriore. Kjo ka ndikuar që bashkat-



dhetarët ta ndryshojnë edhe kohën e ardhjes, ta zëmë qershor-korrik dhe deri dje kanë hyrë në Kosovë mbi 205 mijë, kur them polisa përfshin edhe vetura edhe kategori të tjera, mirëpo viteve tjera kjo ka ndodhur vetëm në korrik dhe gusht, pra e kanë ndryshuar kohën e ardhjes. Ky ndryshim ka ardhur sepse ata kanë ardhur edhe nga pikat tjera kufitare”, është shprehur ai.

MAZREKU: VONESA NJË MINUTËSHE PËR PLOTËSIMIN E POLISËS KUFITARE NGA BKS-JA

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku ka thënë se këtë vit numri i mërgimtarëve që kanë hyrë në Kosovë është pak më i madh.

“Nëse flasim për periudhën janar-gusht, sivjet është një numër më i madh i polisave, jo shumë më i madh, dallimi është te sezona sepse vitin e kaluar e kemi ditur javën e parë, të dytë e të tretë të korrikut dhe jemi përgatitur, ndërsa sivjet të premtën është dashur ta porosisim një kabinë të re, që të hënë jetë e montuar për arsye se Vermica ka pasur një fluks shumë më të madh sivjet në krahasim me vitin e kaluar”, ka thënë ai për Front Online.

Kur është pyetur se në cilën pjesë të kufirit ka pasur më shumë pritje, Mazreku ka treguar se nga pjesa e shtetit serb vonesat kanë qenë më të mëdha.

“Dihet që kah pjesa e shtetit serb ka më shumë vonesa dhe dihet arsyeja pse, ndërsa në pjesët tjera është një tempo e njëjtë, mirëpo nëse flasim për vonesa te zyra jonë, nuk po flas për vonesa të tjera sepse policia kufitare ka tjetër ligj, p.sh., e kanë obligim që çdo veturë e huaj që vjen e ka për obligim ta regjistrojë në sistem, ndërsa tek ne një qytetar pret më pak se një minutë për me marr një policë të sigurimit”, ka shtuar Mazreku.

MAZREKU: QYTETARËT S’KANË NEVOJË TË PAGUAJNË MË TATIM NË PRONË PËR REGJISTRIM TË VETURËS

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku në një intervistë për Front Online ka treguar se më qytetarët nuk do të paguajnë tatim në pronë për regjistrim të veturës.

Krejt, kjo pas ankesës që ka bërë ky i fundit që nga vitit 2019 në Institucionin e Avokatit të Popullit.

“Në kohën kur e kemi bërë këtë ankesë në vitin 2019, menjëherë kemi marrë njoftim që ankesa ka bazë për hetim dhe ne mendojmë se kjo është kundër-kushtetuese, nuk i di arsyet pse prej vitit 2019 deri më tani nuk ka ndodhur asgjë, dhe çdo qeveri që ka ardhur ne kemi dërguar edhe shkresa në Ministri të Financave dhe konkretisht te ministri Murati. Duke e parë se është një pengesë që ndikon negativisht në këtë proces e ka pezulluar një rregullore të MF-së, sepse me rregullore u jepej të drejtë komunave të bëjnë kushtëzime të tilla dhe deri para së të hyjë në fuqi ligji i ri tash ajo rregullore ka qenë e pezulluar, nuk ka qenë e anuluar e as nuk ka qenë e ndryshuar. Mirëpo, në ndërkohë MF-ja i ka marrë rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe i ka vendosur në ligj që sot t’i mund të shkosh dhe ta paguash një taksë 10 euro, mirëpo nuk ke kushtëzime tjera, si p.sh. ta paguash tatimin në pronë”, është shprehur Mazreku.

Sipas tij, arsyeja se pse ka bërë ankesë ka qenë që kanë parë që ligji me këto kushtëzime që u janë bërë qytetarëve ka qenë diskriminues.

“Nëse me ligj është e rregulluar që tatimi të mblihet në mënyrë të kushtëzuar, është tentuar që të demtohet një sektor tjetër, ne e kemi parë që kjo është e padrejtë dhe çka kemi bërë në vitin 2019, personalisht në emrin tim jam ankuar te Avokati i Popullit që ky ligj është diskriminues sepse asnjë qytetar nuk ka pengesa, nuk ka ankesa që të shkojë ta paguaj një taksë 10 euro për regjistrimin e veturës. Ata e kanë paguar me kënaqësi, por kur u thuhet që përveç kësaj takse duhet ta paguash edhe tatimin në pronë, dikush që ka pasur tatim pak e ka paguar edhe ne nuk kemi kundër pagesës së tatimit në pronë. Mirëpo kjo ka shkuar duke i përshkallëzuar kushtëzimet dhe çka kemi bërë, kemi thënë që nuk ka asnjë kushtëzim për regjistrimin e veturave”, ka deklaruar ai.

MAZREKU: NUMRI I VETURAVE TË PAREGJISTRUARA KA RËNË NGA 237 MIJË NË 18-19 MIJË

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku në një intervistë për Front Online, ka thënë se numri i veturave të paregjistruara në Kosovë krahasuar me dy vitet e kaluara ka rënë dukshëm.

Nga mbi 230 mijë sa kanë qenë ka rënë në 18-19 mijë.

“Pastaj kemi vazhduar me vendosjen e stikerave dhe nga 237 mijë vetura sa kanë qenë para dy vitesh tani janë vetëm 18 mijë ose 19 mijë, që i bie që mbi 30% ka rënë numri, pra qëllimi ka qenë që edhe të lehtësohen procedurat edhe të hiqen barrierat dhe në anën tjetër ne si industri e sigurimeve të lehtësojmë procedurat dhe të mos kemi në trafik vetura të paregjistruara. Stikersat kanë qenë njëfarë



ombrelle dhe përfundimi i asaj që ka qenë një hap i fundit që ne me i kemi ndihmuar Policinë që këto vetura t’i identifikojnë dhe t’i dallojnë në trafik”, ka deklaruar Mazreku për Front Online.

Të hyrat u rriten për 14,75%

Të hyrat e industrisë së sigurimeve gjatë periudhës janar-qershor 2023 kanë arritur në 66.642.906 euro, nga 58.076.248 euro sa ishin gjatë periudhës janar-qershor 2022. Krahasuar me periudhën paraprake, sivjet të hyrat e industrisë u rritën për 14,75 %.

Më shumë se 66 milionë euro janë të hyrat e industrisë së sigurimeve në vend gjatë periudhës janar-qershor 2023, nga 58.076.248 sa ishin në periudhën

e njëjtë të vitit paraprak. Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, shihet se të hyrat e industrisë u rritën për 14,75 %. Rritja e të hyrave

po ndodh në vazhdimësi si pasojë e rritjes së tregut, por edhe rritjes së sigurimeve vullnetare në vend.

MUAJI	2023	2022	2021	2020
Qershor	66.642.906	58.076.248	53.059.335	44.661.331
Maj	53.867.441	45.800.000	40.715.306	34.207.353
Prill	42.648.000	32.245.902	31.813.340	26.444.774
Mars	32.387.592	27.880.722	24.654.027	21.907.935
Shkurt	20.697.665	18.458.444	16.039.024	16.083.501
Janar	11.048.735	10.152.736	8.812.657	7.848.176

14,5%

janë rritur të hyrat e industrisë së sigurimeve gjatë periudhës janar-qershor 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



66,642,906€

janë të hyrat e Industrisë së sigurimeve gjatë periudhës janar-qershor 2023.



58,076,248€

janë të hyrat e Industrisë së sigurimeve gjatë periudhës janar-qershor 2023.